



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD OR THE CIVIL SERVICE O KOSOVA

Datë: 26.05.2025
Numër Protokolli: 4232/2025

A.nr.562/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Kaltrina Avdullahi, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.562/2025, të datës 27.03.2025, të parashtruar nga ankuesi S.Ll., kundër organit të punësimit: Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3, dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 26.05.2025, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprobuhet pjesërisht si e bazuar** ankesa me numër A.nr.562/2025, e datës 27.03.2025, e parashtruar nga ankuesi S.Ll., ashtu që, aprovet pretendimi për parregullsi ligjore, ndërsa, refuzohet pretendimi lidhur me vlerësimin e ankuesit në testin më shkrim.
- II. Anulohet** procedura e pranimit me numër reference RN00015835, për pozitën Drejtor i Departamentit për Dixhitalizimin e Arsimit, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.
- III. Obligohet** Njësia e Burimeve Njerëzore të Agjencisë të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, që të ndërmarr veprimet e nevojshme administrative me qëllim të zbatimit të këtij vendimi siç përcaktohet në II të dispozitivit, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës** duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi S.Ll. (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), më datë 25.03.2025, përmes Postës së Kosovës ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e pranuar më datë 27.03.2025, dhe e regjistruar nën shenjën A.nr.562/2025, kundër procedurës së rekrutimit me numër reference RN00015835, për pozitën Drejtor i Departamentit për Dixhitalizimin e Arsimit, të shpallur nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 15.04.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, ndërsa, kjo e fundit, më datë 28.04.2025, ka përcjellë përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat referuar çështjes ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) pas konstatimit se ankesa është e pranueshme në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi për shqyrtimin e të njëjtës, kështu që për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 2067/2025 të datës 25.03.2025, të pranuar në Këshill me 27.03.2025, të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formularin e parashtrimit të ankesës të datës 27.03.2025; Pliko e datës 25.03.2025, nga Posta e Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 15.04.2025 (së bashku me rikujtimet e kërkesës); Përgjigjen në ankesë të datës 28.04.2025 së bashku me dokumentet e bashkangjitura; Kopjen e konkursit me ref: RN00015835; Kërkesën e datës 20.11.2025; Ftesën për testin me shkrim të datës 30.01.2025; Listën e aplikantëve; Aplikacionin me datë aplikimi 16.12.2025, të kandidatit F.N së bashku me dokumentet e bashkangjitura; Aplikacionin me datë aplikimi 25.11.2025, të kandidatit S.L1 së bashku me dokumentet e bashkangjitura; Aplikacionin me datë aplikimi 27.11.2025, të kandidatit M.S së bashku me dokumentet e bashkangjitura; Vendimin Nr.2-247 të datës 27.01.2025; Ftesën për intervistë me gojë të datës 21.02.2025; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën përkatëse; Vendimin Nr.2-2195 të datës 01.10.2025; Akt emërimit Nr.33/2024 të datës 30.07.2024; Akt emërimit Nr: 010 të datës 11.09.2015; akt emërimit e datës 14.11.2012; Akt emërimit Nr.02/2023 të datës 01.06.2023; Vendimin e datës 30.01.2025; Vendimin për vazhdimin e afatit të procedurës V.Nr.01/2025 të datës 06.01.2025; Njoftimin përfundimtar Nr. 21/2025 të datës 24.02.2025; Njoftimin e datës 14.02.2025; Formularin e vlerësimit të përgjithshëm datës 14.02.2025; Formularin e vlerësimit të përgjithshëm të kandidatëve në intervistë të datës 24.02.2025; Renditjen përfundimtare të kandidatëve të datës 24.02.2025; Esenë së bashku me çelësin e esesë; Testin me shkrim; Vendimin me numër protokolli 3179/2025, të datës 15.05.2025, të Kryetarit të Këshillit.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa e parashtruar nga ankuesi, është pjesërisht e bazuar, **sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës, rezulton se Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, më datë 21.11.2024, ka shpallë konkursin publik për praninë me numër reference RN00015835, për pozitën Drejtor i Departamentit për Digjitalizimin e Arsimit, me klasë të pozitës Drejtues i Mesëm, me mandat katër vjeçar, i hapur për aplikim 22.11.2024 deri më 21.12.2024.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsejtë tre (3), kandidatë përfshirë ankuesi, i cili e ka kaluar fazën e verifikimit paraprak dhe së i njëjti së bashku me dy kandidatët tjerë i është nënshtruar edhe fazës së vlerësimit profesional, mirëpo, testin më shkrim e ka kaluar vetëm kandidati F.N., gjegjësisht ankuesi ka arritur 47.6 pikë, si pikë të pamjaftueshme për të vazhduar me fazën tjetër të vlerësimit, gjegjësisht vlerësimit të intervistës me gojë.

Divizioni për Burime Njerëzore në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, më datë 24.02.2025, ka publikuar Njoftimin për renditjen përfundimtare të kandidatëve, nga i cili njoftim rezulton se si kandidatë i suksesshëm për këtë pozitë është shpallur F.Sh. me gjithsejtë 76.4 pikë.

Ankuesi brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke kundërshtuar vlerësimin e testit me shkrim, gjegjësisht vlerësimin e eses, me pretendimin ankimor se sipas ankuesit eseja nga ana e Komisionit të Pranimit nuk është vlerësuar në

mënyrë meritore, tutje shton procedura e kontestuar është përcjell edhe me parregullsi tjera pasi që dyshoj së janë bërë “ *Dallavere të mëdha*”. Kërkon nga Këshilli që të rivlerësoj esenë e ankuesit ose të anulohet konkursi.

Kolegji i Këshillit mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, e ndërlidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: “*Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes*”, ka analizuar në kuptim të ligjshmërisë veprimet procedurale të ndërmarra në procedurën e pranimit më numër të referencës RN00015835, respektivisht për pozitën e punës Drejtor i Departamentit për Digjitalizimin e Arsimit, dhe si rrjedhojë fillimisht analizoj aktin e shpalljes së konkursit ku si kritere të përgjithshme formale, për pozitën e shpallur janë përcaktuar: **Arsimimi i kërkuar:** Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor). **Arsim i lartë i paspecifikuar, Përvoja e punës e kërkuar:** Së paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale duke përfshirë njërën nga kërkesat në vijmë: tre (3) vite përvojë pune në pozita drejtuese, dy (2) vite përvojë pune në pozita drejtuese dhe diplomë e nivelit të dytë të arsimit të lartë (master), ose një (1) vit përvojë pune në pozitë drejtuese dhe diplomë e nivelit të tretë të arsimit të lartë (doktoraturës).

Ndërsa, në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit iu referuar dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrarët Publikë, më theks të veçantë:

-Neni 9: 1. *Kriteret e përgjithshme që një person duhet t'i plotësojë në procedurën e rekrutimit, për t'u pranuar si zyrtar publik në cilëndo kategori apo nivel, janë: 1.1. të jetë shtetasi Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi; 1.3. të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët; 1.4. të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse; 1.5. të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje; 1.6. të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik; 1.7. të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës; dhe 1.8. të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj. 2.Përrjashtimisht, për pozita specifike të zyrtares/it publik, mund të kërkohej kritere specifike shtesë. Procedura dhe kriteret për plotësimin e përshtatshmërisë dhe/apo të kriterëve specifike shtesë, do të përcaktohet me akt nënligjor të miratuar nga Qeveria, me propozim të ministrisë përgjegjëse për administratë publike.*

-Neni 44 :1. *Pranimi në pozitë të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese bëhet me konkurs të hapur dhe publik të organizuar për çdo pozitë të lirë. 2. Procedura e rekrutimit organizohet nga njësi përgjegjëse për institucionet e administratës shtetërore dhe nga NjMBNj për çdo institucion tjetër shtetëror. 3. Shpallja e procedurës së rekrutimit bëhet nga njësi përgjegjëse, në SIMBNj-së, në ueb faqen e institucionit përkatës, si dhe me mjete të tjera të përshtatshme të informimit. 4. Pranimi i aplikacioneve bëhet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e shpalljes së procedurës së rekrutimit. 5. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 5.1. verifikimi paraprak, përmes së cilit verifikohet nëse kandidatet/ët plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të posaçme, sipas shpalljes së konkursit; dhe 5.2. vlerësimi profesional, që përfshin vlerësimin e njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidateve/ëve. 6. Verifikimi paraprak kryhet nga njësi përgjegjëse, ndërsa vlerësimi profesional kryhet nga komisioni i pranimit për pozita të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese. 7. Vlerësimi profesional i kandidateve/ëve përfshin testim me shkrim në formë elektronike ku sigurohet anonimiteti i konkurrentëve, si dhe intervistë me gojë. 8. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është njëqind (100) pikë.*

Po ashtu, për vendosje të drejtë dhe meritore Kolegji i Këshillit mori për bazë edhe Rregulloren (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, dhe atë: Nenin 7 paragrafi 1 dhe 2 është përcaktuar: 1. *Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidatët për pranim në shërbimin civil plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit. 2. Verifikimi*

paraparak kryhet nga NjMBNj, më së largu pesëmbëdhjetë (15) ditë pas kalimit të afatit për pranimin e aplikacioneve, në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikimit,...” si dhe nenin 11 paragrafi 1 dhe 2, ku është përcaktuar: 1. Vlerësimi përfundimtar i kandidatit përfshin shumën e pikëve të përfituara në secilin hap të vlerësimit. 2. Pas përfundimit të intervistës, Komisioni i Pranimit përgatit listën përfundimtare të kandidatëve që kanë kaluar pragun prej 70% të pikëve totale që e përcjell te NjMBNj, emrin dhe mbiemrin e kandidatit fitues, si dhe pikët e arritura në testin me shkrim, intervistën dhe pikët e përgjithshme për secilin kandidat.

Si rrjedhojë, bazuar në kuadrin përkatës ligjor, si dhe shqyrtimit dhe analizimit të provave të lëndës Kolegji ka gjetur se pretendimi ankimor i ankuesit lidhur me vlerësimin jo të drejtë të eses, nuk gjen mbështetje, sepse nga analizimi i përmbajtjes së testit me shkrim të aplikuar në këtë procedurë rekrutimi, Kolegji ka vërtetuar së pyetjet e testit kanë qenë të njëjta për të gjithë kandidatët, testi ka përmbajt 25 pyetje më përgjigje të shumëfishta dhe një pyetje në formë të eseja, pra, testi me shkrim ka qenë në pajtim më kërkesat ligjore të përcaktuara me nenin 9, paragrafi 5 dhe 6 të Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Rrjedhimisht, Kolegji nuk verën të meta në vlerësimin e drejtë të ankuesit lidhur me testin me shkrim, sepse, ankuesi ka dhënë 17 përgjigje të sakta, duke u vlerësuar më 34 pikë (çdo përgjigje e saktë e vlerësuar me nga dy pikë), ndërsa, në ese është vlerësuar me 13.6 pikë nga 20 pikë maksimale, duke arritur gjithsej 47.6 pikë, si pikë të pamjaftueshme për të vazhduar me fazën tjetër të vlerësimit, sikurse parashihet me nenin 9 paragrafi 4 të Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se: 4. *Testimin me shkrim e kalojnë vetëm kandidatët që marrin të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim.* Kështu që, mbi këtë bazë, e duke qenë së vlerësimi i eses është vlerësim diskrecional i anëtarëve të Komisionit të Pranimit, atëherë, Kolegji mbi këto rrethana nuk mund të vërtetoj një vlerësim tjetër në mungesë të argumentimit nga pala ankuese.

Kolegji në kuptim të respektimit të parimit të meritokracisë si parim bazë për pranim në shërbimin civil, ka shqyrtuar dosjen e kandidatit fitues F.Sh., e dorëzuar më rastin e përgjigjes në ankesë, ku si pasojë ka gjetur së i njëjti posedon Diplomën me numër Nr. D-82/15, të datës 09.06.2016, për përfundimin e studimeve themelore më datë 29.09.2015, në programin Studime të Integruara Evropiane, Kolegji ISPE, Diplomën nr.1633324, të datës 12.12.2018, të lëshuar nga University of Warsaw në Poloni, për përfundimin e studimeve Master në Programin e Shkencave Politike si dhe Vendimin me numër reference Ref.nr.6-1081 të datës 19.03.2019, të lëshuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, për njohjen e gradës “Master i Shkencave Politike”, në Universitetin e Varshavës në Poloni. Ndërsa, lidhur me përvojën e punës ka ofruar si dëshmi:

-Shkresë nr.prot.312/A/13, të datës 22.07.2016, të lëshuar nga Këshilli i Rinisë Evropiane të Kosovës, sipas të cilës shkresë konfirmohet së F.N. është senator pranë këtij Këshilli nga legjislatura e I-rë e vitit 2009 dhe vazhdon të jetë edhe në legjislaturën e II-të

-Shkresën më nr.6021/18, të datës 15.08.2018, të lëshuar nga Kolegji ISP, e sipas të cilit vërtetohet së ka F. N., ka qenë i punuar më orar të plotë në këtë Kolegji nga data 01.10.2014 deri me datë 30.03.2015;

-Shkresën e datës 20.04.2021, të lëshuar nga kompania private “Petroleum Coke Kosova”, e sipas të cilës shkresë, rrjedhë së ankuesi që nga 2016 dhe kryesisht nga 2018 ka qenë i angazhuar si konsulent në këtë kompani (kjo shkresë nuk përmban kohë të sakta të angazhimit);

-Vërtetimin e lëshuar nga Sekretari Koordinues, Zyra e Kryeministrit (pa datë dhe numër protokolli) përmes së cilit vërtetohet se i njëjti ka qenë praktikant në Zyrën e Kryeministrit, në Projektin për Zhvillimin dhe Koordinimin e Politikave për periudhën një muaj e gjysme (duke filluar nga 01.09.2016),

-Certifikatë e datës 20.08.2018, të lëshuar nga Sh.P.K Xhela, me të cilin vërtetohet se kandidati F.Sh. ka qenë Menaxher i Projekteve dhe atë nga data 01.08.2010 deri më datën 30.09.2016 (mbi 6 vite);

-Kontratën ref.2.4 të datës 15.01.2019, të lidhur me MINT-KIESA ku kandidati ka qenë si konsulent shërbimesh më titull “Matching grants programm manager”, i financuar Banka Botërore (e sipas kësaj kontrate nuk specifikohet kohëzgjatja e angazhimit);

-Kontratën për shërbime konsulente të lidhur me Ministrinë E Shëndetësisë dhe F. Sh., (e sipas kësaj kontrate nuk specifikohet kohëzgjatja e angazhimit);

-Kontratën për shërbime konsulenti më ref:Kode/IC/2.24, 3a/2022 të datës 29.09.2022, të lidhur me Ministrinë e Ekonomisë lidhur me Projektin Ekonomia Digjitale e Kosovës (sipas kësaj kontrate nuk specifikohet kohëzgjatja e angazhimit);

-Shkresën e datës 29.09.2020, të lëshuar nga U.D Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë KIESA, sipas të cilës është theksuar së ankuesi nga janari 2019 deri në korrik 2020, ka punuar në KIESA , si menaxher/konsulent dhe ka udhëhequr Programin e Garantëve të Përgjithshme të Projekt të CERPO, të financuar nga Banka Botërore;

-Kontratën më nr.6021/18, të datës 15.08.2018, të lëshuar nga Kolegji “ISP”, e sipas të cilit vërtetohet së ka qene i punësuar më orar të plotë në këtë Kolegj, nga 01.10.2014 deri me 30.03.2015;

-Certifikatën e biznesit DIA CONSULTIN SH.P.K, të datës 08.03.2023. Sipas Certifikatës dhe shënimeve të regjistrimit lidhur me biznesin DIA CONSULTIN SH.P.K, rezulton së ky biznes është regjistruar me datë 15.09.2015, ku ankuesi është i deklaruar në cilësinë e pronarit/drejtorit, ndërsa ankuesi në aplikacionin e tij ka përshkruar se në këtë pozitë ka punuar nga data 01.06.2022 dhe vazhdon, kurse sipas Pasqyrës së Trustit Pensional i Kosovës (të nxjerrë më datë 18.09.2024) të dorëzuar gjatë aplikimit, rrjedhë së ankuesi ka qenë i angazhuar për periudhën qershor-dhjetor 2022, janar-dhjetor 2023, janar –gusht 2024);

-Kontratën me numër protokollit 3930/45-10, të datës 12.04.2019, të lidhur me Kolegjin “UBT”, në kohëzgjatje prej 01.04.2019 deri 01.04.2022.

Rrjedhimisht, lidhur me përvojën e punës profesionale dhe menaxhuese pas diplomimit, kandidati fitues ka ofruar dyshim të besueshme dhe të vlefshme vetëm për:

-Zyra e Kryeministrit, shtator-tetor 2016, gjithsej 1 muaj e gjysmë;

-Kompania private “Petroleum Coke Kosova”, periudha korrik, gusht, shtator, tetor, nëntor dhe dhjetor 2018, janar - dhjetor 2019, janar, shkurt, qershor, korrik 2020, total 22 muaj;

-KIESA-MINT, janar-dhjetor 2019, janar-korrik 2020, total 19 muaj;

-Ministria e Ekonomisë, gusht - dhjetor 2022, janar-dhjetor 2023, janar-korrik 2024, total 24 muaj;

-Ministria e Shëndetësisë, qershor 2021, total 1 muaj.

-DIA CONSULTIN SH.P.K- qershor-dhjetor 2022, janar-dhjetor 2023, janar –gusht 2024, gjithsej 27 muaj.

-Kolegji “UBT” maj- korrik 2019, total 3 muaj.

Referuar gjendjes së fakteve si më lartë, Kolegji vlerëson së kandidati F.Sh. nuk ka 60 muaj apo 5 vite përvojë pune, ashtu siç është kërkuar më konkurs. Gjegjësisht, angazhimi në Këshillin e Rinisë Evropiane të Kosovës e konfirmuar sipas Shkresës nr.prot.312/A/13 të datës 22.07.2016 dhe duke qenë se nuk ka dëshmi tjera që konfirmojnë kohëzgjatjen e këtij angazhimi, është angazhim para diplomimit, përvoja e punës së ankuesit në Kolegjin “ISP”, e deklaruar sipas shkresës nr.602/18 të datës 15.30.2018 në kohëzgjatje 01.10.2014 deri me datë 30.03.2015, po ashtu është përvojë para diplomimit, si dhe përvoja e punës tek Kompania “Xhela”, e konfirmuar sipas Certifikatës së datës 20.08.2018, se kandidati F.N. ka punuar si projekt menaxher në periudhën kohore 01.08.2010 deri

me 30.09.2016, nuk përputhet me dëshminë e Trustit, rrejdhimisht sipas Pasqyrës së Trustit Pensional të datës 18.09.2024, ankuesi pranë kësaj kompanie ka punuar për periudhën maj 2014, mars, prill maj, qershor, korrik, gusht, shtator dhe nëntor 2015, përvoja kjo po ashtu para diplomimit, pasi që F. Shala ka diplomuar më datë 29.09.2015. Ndërsa. përvoja e punës së ankuesit në UBT, sipas Kontratës me numër protokollit 3930/45-10 të datës 12.04.2019, në kohëzgjatje prej 01.04.2019 deri 01.04.2022, nuk është e mbuluar në tërësi me dëshmi nga Trusti Pensional apo Administrata Tatimore, në fakt sipas Pasqyrës së Trustit të datës 18.09.2024, del se F.N. ka punuar në këtë Kolegj vetëm për periudhën maj, qershor dhe korrik 2019.

Në kontest të përvojës profesionale, Kolegji thekson faktin se përvojë profesional konsiderohet vetëm përvoja në fushën e arsimit që posedon kandidati dhe atë pas diplomimit në studime themelore, përcaktim ky tashme i konsoliduar më praktiken vendimmarrës të Këshillit dhe praktiken vendimmarrëse të gjykatës (aktgjykimi i Gjykatës së Apelit AA.nr.614/2025). Rrjedhimisht, përvoja e punës në të njëjtën kohë në dy apo më shumë vende pune, siç rezulton në rastin e kandidatit F. Noli, cilësohet vetëm si një përvojë pune dhe vetëm për një periudhë kohore, pasi që, përvoja e punës llogaritet për periudhë kohore. Në fakt, në ndërlidhje me këtë konstatim, Kolegji ka evidentuar së kandidati F.N. në vitin 2019, ka përvojë pune njëkohësisht në Kompaninë private “Petroleum Coke Kosova” dhe Kolegjin “ UBT”, (periudha maj, qershor dhe korrik), në vitin 2020, ka punuar në të njëjtën kohë në Kompaninë private “Petroleum Coke Kosova” dhe KIESA-MINT(periudha janar-korrik 2020), në vitin 2022, ka punuar në të njëjtën kohë në Ministrinë e Ekonomisë dhe DIA CONSULTIN SH.P.K (qershor-dhjetor 2022), në vitin 2023, ka punuar në të njëjtën kohë në Ministrinë e Ekonomisë dhe DIA CONSULTIN SH.P.K (janar -dhjetor 2023), dhe në vitin 2024, ka punuar në të njëjtën kohë në përvojë punë në Ministrinë e Ekonomisë dhe DIA CONSULTIN SH.P.K (janar-korrik 2024).

Rrjedhimisht, referuar dëshmime të analizuara si sipër, Kolegji konstaton se kandidati F. N., i deklaruar si kandidat i suksesshme, nuk ka plotësuar kriteret formale të përgjithshme për pozitën e punës Drejtor i Departamentit për Digjitalizimin e Arsimit, sepse, siç u konstatua më sipër i njëjti nuk ka plotësuar kriterin e përvojës së punës së kërkuar sipas pikës 5 të konkursit, kështu që, nisur nga këto rrethana, rrjedhë së Njësia Përgjegjëse në këtë rast Njësia e Personelit të MASHT-it, nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale duke përfshirë kandidatin F.N. (i shpallur edhe kandidat fitues), në listën e kandidateve që ka plotësuar kriteret formale të konkursit, veprime këto në kundërshtim më nenin 39 paragrafi 7 pika 7.1 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrarët Publik. Andaj, duke qenë së kandidati F.N. ka qenë kandidati i vetëm i suksesshëm në këtë procedurë të pranimit, mirëpo, meqë i njëjti nuk ka plotësuar kriteret formale për pozitën përkatëse të shpallur, atëherë, në mungesë të kandidatëve tjerë të suksesshmen, Kolegji nuk ka gjetur bazë për lënien në fuqi të kësaj procedure të pranimit, dhe si pasojë Kolegji duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, rrejdhimisht e aprovoj ankesën pjesërisht si të bazuar dhe anuloi në tërësi procedurën e pranimit me numër reference RN00015835, për pozitën Drejtor i Departamentit për Dixhitalizimin e Arsimit, të shpallur nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.

Këshillë juridike: Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.562/2025

Kaltrina Avdullahi Prenaj

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- *Ankuesit, S.Ll.;*
- *Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit; dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*